

Bashkia: POGRADEC

Kryetar: EDUART KAPRI

Fusha: INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

Premtime:

1. Do të ndërtohen dhe mirëmbahen rrjeti rrugor që është nën juridiksionin e Bashkisë, në zonat urbane dhe rurale
2. Do të kryhet sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza në të gjitha fshatrat e Bashkisë Pogradec
3. Do të kryhet ndërtimi dhe mirëmbajtja e ujësjellësave në territorin e bashkisë për të siguruar furnizimin e banorëve me ujë të pijshëm
4. Do të sigurohet ndriçimi publik në të gjitha hapësirat e banuara, lagje dhe fshatra, si dhe përdorimi i burimeve alternative të energjisë në qytetin e Pogradecit
5. Do të kryhet mirëmbajtja dhe rehabilitimi i varrezave të qytetit të Pogradecit; Mirëmbajtja, rehabilitimi dhe rrethimi i varre-zave në të gjitha fshatrat e Bashkisë Pogradec
6. Do të sigurohet ndriçimi publik në Lagjen 2, Pogradec
7. Do të përmirësohet infrastruktura e tregut në Lagjen 2, Pogradec
8. Do të përfundojnë punimet për kanalizimet e ujërave të zeza në Lagjen 2, Pogradec
9. Do të mirëmbahen hapsirat publike në Lagjen 2, Pogradec
10. Do të mirëmbahen rrugët dhe trotualet në Lagjen 2, Pogradec
11. Do të ulet tarifa fikse e ujit të pijshëm në Lagjen 2, Pogradec
12. Do të kryhet një masterplan për bregun e liqenit, në Lin, me prioritet për turizmin
13. Do të punohet me sistemin e ujit dhe ujit të pijshëm, në Udënisht
14. Do të kryhet sistemimi i kanalizimeve të ujërave të zeza në Udënisht
15. Do të kryhet sistemimi i rrugëve në Udënisht
16. Do të kryhet sistemimi i lumit në Udënisht
17. Do të kryhet pastrimi i liqenit dhe bregliqenit në Udënisht
18. Do të kryhet sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza në Memlisht
19. Do të kryhet ndërtimi i rrugës në Memlisht
20. Do të kryhet furnizimi me ujë të pijshëm në Çervenakë
21. Do të kryhet furnizimi me ujë të pijshëm në Memlisht
22. Do të kryhet sistemimi i kanalizimeve të ujërave të zeza në Boqezë
23. Transporti brenda Bashkisë, në Udënisht, do të bëhet me furgonë të vegjël
24. Do të restaurohet rruga lidhëse në Homezh me Çervenakën
25. Do të kryhet sistemimi i kanalizimeve të ujërave të zeza në Çervenakën
26. Do të ofrohet ndihmesë për përmbushjen e procedurave për shtëpitë e palegalizuara në Çervenakë
27. Do të kryhet sistemimi i lumit, në Vërdovë
28. Do të zgjidhet problemi i ujit të pijshëm në Vërdovë

29. Do të përmirësohet rrjeti i amortizuar elektrik, në Vërdovë
30. Do të kryhet sistemimi i varrezave në Vërdovë
31. Do të rikonstruktohet infrastruktura rrugore, në Vërdovë
32. Do të investohet në ujën e pijshëm në fshatrat Remenj dhe Zervask
33. Do të investohet në kanalizimet në fshatrat Remenj dhe Zervask
34. Do të investohet në varrezat në fshatrat Remenj dhe Zervask
35. Do të sigurohet ndriçimi rrugor në Zervask
36. Do të zgjidhet problemi i ujit të pijshëm në Zagoraç
37. Do të restaurohet infrastruktura rrugore për rrugën hyrëse të Zagorçanit
38. Do të ndërtohet kanalizimi i ujërave të zeza në Rëmenj
39. Do të restaurohet sistemi i ujërave të zeza në Starovë
40. Do të kryhet mirëmbajtja e rrjetit rrugor të brendshëm, në Starovë
41. Do të zgjidhet problemi i ujit të pijshëm, në Alarup
42. Do të përmirësohet sistemi i ujësjellësit, në Leshnicë, në mënyrë që çdo shtëpi të ketë ujë të pijshëm
43. Do të kryhet sistemimi i rrugëve të fshatit në Nizhavec
44. Do të kryhet rregullimi i rrjetit të brendshëm rrugor në Petrushë
45. Do të kryhet asfaltimi i rrugës Çërravë - Lumas
46. Do të kryhet asfaltimi i rrugës Petrushë - Nizhavec
47. Do të kryhet rikonstruksioni i rrugëve të brendshme në Lumas
48. Do të rikonstruktohet infrastruktura rrugore, në Leshnicë
49. Do të sigurohet uji i pijshëm, në Çërravë
50. Do të rikonstruktohet sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe të bardha, në Çërravë
51. Do të rikonstruktohen rrugët e brendshme, në Çërravë
52. Do të kryhet kanalizimi i ujërave të zeza, në mënyrë që të mos infektohet uji i pijshëm Bratomirë
53. Do të kryhet pëmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm, në Nizhavec
54. Do të kryhet pëmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm, në Petrushë
55. Do të kryhet pëmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm, në Qershizë
56. Do të restaurohet sistemi i ujërave të zeza në Qershizë
57. Do të restaurohet sistemi i ujërave të zeza në Bletas
58. Do të restaurohet ndriçimi rrugor në Bletas
59. Do të restaurohet ndriçimi rrugor në Alarup
60. Do të restaurohet ndriçimi rrugor në Lumas
61. Do të restaurohet ndriçimi rrugor në Grabovicë
62. Do të restaurohet sistemi i ujërave të zeza në Leshnicë
63. Do të restaurohet infrastruktura rrugore e brendshme e fshatit Bratomirë
64. Do të përmirësohet sistemimi i kanalizimit të ujërave të zeza dhe të bardha në Grabovicë
65. Do të restaurohet sistemimi i rrugëve të brendshme, mbi rrugën kryesore në Alarup
66. Do të kryhet mirëmbajtja e rrugës në Grabovicë
67. Do të përmirësohet sistemimi i varrezave të fshatit Grabovicë
68. Do të zgjidhet problemi i tokave që nuk figurojnë në kadastër në Grabovicë
69. Do të realizohen rrugët dytësore në Beragoshdë

70. Do të kryhet hapja e rrugëve në parcelat e tokave bujqësore në Beragozhde
71. Do të kryhet ndriçimi rrugëve në Stropskë
72. Do të kryhet sistemimi i kanalizimit të ujërave të zeza në Stropskë
73. Do të kryhet mirëmbajtja e varrezave, si dhe shtrimi i rrugës që të çon tek varrezat në Stropskë
74. Do të kryhet sigurimi i ujit të pijshëm në Stropskë
75. Do të kryhet hapja e rrugëve në parcelat e tokave bujqësore në Stropskë
76. Do të kryhet sistemimi i rrugëve të lagjeve në Stropskë
77. Do të kryhet rikonstruksioni i Ujësjellësit të fshatit Beragozhde
78. Do të kryhet ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve në Trebinjë
79. Do të kryhet ndriçimi rrugor në Trebinjë
80. Do të kryhet ndërtimi i rrugës kryesore në Pleshisht
81. Do të kryhet ndërtimi i rrugës kryesore në Dunicë
82. Do të ndërtohet ujësjellësi në Pleshisht
83. Do të sigurohet furnizimi me ujë të pijshëm në Dunicë
84. Do të kryhet ndërtimi i rrugës që lidh Dunicën me Gurin e bardhë
85. Do të kryhet ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugës në Malinë
86. Do të kryhet sistemimi i kanaleve vaditëse në Malinë
87. Do të restaurohet infrastruktura rrugore, në Propisht
88. Do të rikonstruktohet ujësjellësi, në Propisht
89. Do të sigurohet shërbimi shëndetësor 24 orë, në Propisht
90. Do të kryhet sigurimi i ujit të pijshëm në Zall Torre
91. Do të kryhet ndërtimi i urës kryesore që lidh Zall Torre me Golikun
92. Do të kryhet ndriçimi rrugor në Zall Torre
93. Do të kryhet ndërtimi i rrugës në Homezh
94. Do të kryhet ndërtimi i rrugës Homezh - Çervenakë
95. Do të kryhet ndërtimi i rrugës në Slabinjë
96. Do të kryhet sigurimi i ujit të pijshëm në Slabinjë
97. Do të kryhet furnizimi me ujë të pijshëm në Radokal poshtë dhe Radokal sipër
98. Do të kryhet sistemimi i rrugës kryesore dhe rrugëve të brendshme në Radokal poshtë & Radokal sipër
99. Do të realizohet ndërtimi i rrugës Golik sipër
100. Do të kryhet ndërtimi i rrugës së varrezave në Golik
101. Do të kryhet furnizimi me ujë të pijshëm në Golik
102. Do të kryhet ndriçimi rrugor në Golik
103. Do të kryhet furnizimi me ujë të pijshëm dhe rehabilitimi i rrjetit kryesor dhe linjave të brendshme në Velçan
104. Do të ndërtohet rruga në lagjen Lufo
105. Do të kryhet riparimi i ujësjellësit dhe ndërtimi i rrjetit të brendshëm në fshatrat Bishnicë / Shpellë / Jollë
106. Do të kryhet sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza në fshatrat Bishnicë / Shpellë / Jollë

107. Do të kryhet përmirësimi i godinave të shërbimit shëndetësor në fshatrat Bishnicë / Shpellë / Jollë
108. Do të kryhet sistemimi i kanaleve ujitëse në Velçan
109. "Do të kryhet përfundimi i punimeve për ndërtimin e rrugës që lidhet me fshatin Bishnicë
110. Do të kryhet hapja e rrugëve në parcelat e tokave bujqësore në Buzaishtë
111. Do të kryhet furnizimi me ujë të pijshëm në Buzaishtë
112. Do të kryhet ndërtimi i rrugës kryesore në Losnik
113. Do të kryhet furnizimi me ujë të pijshëm dhe ndërtimi i ujësjellësit në Laktesh
114. Do të kryhet ndërtimi i rrugës që lidh me tregun e fshatit Proptisht dhe rrugët dytësore në Laktesh
115. Do të kryhet rikonstruksioni i qendrës shëndetsore dhe funksionimi i saj në Laktesh

Fusha: ARSIM/KULTURË/SPORT

Premtime:

1. Do të vihet në funksion të artistëve Galeria e Qytetit
2. Do të financohen dhe mbështeten aktivitetet artistike dhe kulturore të grupeve etnokulturore
3. Pallati i kulturës dhe personeli i tij do të punojë me një plan mujor aktivitetesh për të pasur aktivitetet të vazhdueshme kulturore
4. Do të rikonstruktohet kinemaja e qytetit
5. Do të ngrihet Ansambli kulturor i bashkisë
6. Do të realizohet rikonstruksioni i plotë i Pallatit të Kulturës
7. Do të ketë mbështetje financiare për infrastrukturë moderne të ambienteve të artit dhe kulturës
8. Do të mbështeten artistët amator që do të duan të realizojnë shfaqje artistike gjatë sezonit veror
9. Do të rikonstruktohet teatri i kukullave të qytetit
10. Do të financohet një ekspozitë kolektive e piktorëve pogradcar që do të shëtisë në disa qytete
11. Do të financohet një ekspozitë në vit për çdo piktor në Pogradec
12. Do të financohet një ekspozitë në vit për çdo fotograf në Pogradec
13. Do të mbështeten botimet e shkrimtarëve të Pogradecit
14. Do të mbështetet kthimi i ekipit të Pogradecit në ligën e parë
15. Do të restaurohet ambienti sportiv i ekipit të qytetit
16. Do të ketë përkrahje financiare për aktivitetet sportive
17. Do të mbështetet zhvillimi i ekipeve zinxhirë
18. Do të kryhet mirëmbajtja e terreneve sportive në Udënisht
19. Do të investohet në çdo kënd sportiv nëpër shkolla me qëllim që ato të kthehen funksionale për fëmijët
20. Do të kryhet rregullimi oborrit të shkollës në Vërdovë
21. Do të restaurohet shkolla, në Remenj dhe Zervask

22. Do të sigurohet transporti i fëmijëve në shkollë, në Alarup
23. Do të restaurohet kopshti i fshatit në Çërravë
24. Do të kryhet ndërtimi i këndit sportiv në Bletas
25. Do të kryhet rikonstruksioni i shkollës fillore në Nizhavec
26. Do të kryhet rikonstruksioni i shkollës së vjetër 9-vjeçare në Petrushë
27. Do të rikonstruktohet kopshti i fëmijëve në Zall Torre
28. Do të kryhet rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare në Losnik

Fusha: MJEDIS/TURIZËM

Premtime:

1. Do të realizohet infrastrukturë turistike në bashki
2. Do të përmirësohet turizmi malor i cili rrit dhe punësimin
3. Do të rikonstruktohen hapësirat publike në territorin e bashkisë me kënde lojërash, gjelbërim etj
4. Do të hartohet Master Plani Urban – Mjedisor (Plani Rregullues i Territorit), si dokumenti më i rëndësishëm, mbi të cilin do të shtrihet i gjithë aktiviteti publik dhe privat, për të hedhur bazat e një Zhvillimi të Planifikuar dhe të qëndrueshëm urban, për të shmangur spontanitetin në ndërhyrjet në territor dhe gabimet e bëra
5. Do të ndërtohen partneritete për të gjetur zgjidhje përballë sfidave, por edhe oportuniteteve mjedisore dhe urbane, brenda kufijve gjeografikë dhe administrativë të Bashkisë
6. Do të hartohen politika menaxheriale për reduktimin e mbetjeve, grumbullimin dhe riciklimin e tyre; Organizimi i sistemit të grumbullimit të mbetjeve; Krijimi i ‘landfill-it’ (vendgrumbullimit të mbetjeve), si dhe krijimi i qendrës së riciklimit në qytetin e Pogradeci
7. Do të kryhet vendosja e kazanëve për grumbullimin e mbetjeve në zonat e banuara, sipas standarteve europiane, në raport me dendësinë e popullsisë dhe shtrirjen lineare të banesave brenda një lagjeje, apo një fshati; Vendosja e koshave të vegjël për hedhjen e mbeturinave, çdo 100m linear rrugë në rrjetin kryesor dhe dytësor të zonave të banuara
8. Do të kryhet shtimi i zonave dhe hapësirave të gjelbra brenda zonave të banuara dhe bllok-pallateve, të ideuara si zona çlodhjeje dhe kreativiteti; Gjithashtu do të kryhet rehabilitimi i parqeve ekzistuese
9. Do të hartohet Plani i Veprimit për mbrojtjen dhe pastrimin e Liqenit dhe Bregliqenit; Ndërtimi i molit kryesor në Liqenin e Ohrit dhe ndërtimi i disa urave mol, me qëllim stacionimin e varkave dhe anijeve të vogla, si dhe mjeteve të tjera lundruese, në raste aktivitetesh sportive hidrike, si: kanotazh, gara noti, surfing etj
10. Do të vendosen kosha statikë përgjatë bregut të liqenit, në partneritet me sektorin privat, për çdo 50m linear për hedhjen e mbeturinave. Për periudhën Maj - Shtator, grumbullimi i mbetjeve do të kryhet dy herë në ditë
11. Çdo vit për periudhëm Maj-Shtator do të funksionojnë dy grupe pune përgjatë vijës së bregliqenit: a. Grupi I pastrimit dhe mirëmbajtjes; b. Grupi i shpëtimit dhe kontrollit të sipërfaqeve hidrike, për të qënë pranë turistëve dhe mjedisit

12. Do të ketë bashkëpunim të Pushtetit Vendor me Shoqata të Shoqërisë Civile, që kanë në fokus të aktivitetit të tyre, mbrojtjen, konservimin dhe promovimin e mjedisit në Bashkinë e Pogradecit; Angazhimi i rinisë në mbështetje të iniciativave mjedisore, që do të merren periodikisht, në të gjithë hapësirën territoriale administrative të Bashkisë Pogradec
13. Do të kryhet një Plan studimi dhe veprimi (studim fizibiliteti), për kthimin e mbetjeve organike të kafshëve (gjësë së gjallë të blegtorëve) në burim alternativ energjie (peleta) dhe përdorimi i tyre për ngrohjen e kopshteve të fëmijëve dhe shkollave, duke minimizuar kështu, përdorimin e druve të zjarrit dhe lëndëve të tjera djegëse
14. Do të kryhet vendosja e linjës urbane Tushemisht - Lin për banorët e zonave më të rëndësishme turistike të Bashkisë, si një linjë urbane në shërbim edhe të vizitorëve dhe turistëve. Linja e autobuzit urban do të hyjë në funksion brenda 6-mujorit të parë të legjislaturës 2015-2019
15. Do të kryhet rehabilitimi i Parkut Kombëtar në Drilon, si një perlë e natyrës, që duhet ta mbrojmë dhe konservojmë, teksa është një prej aseteve më të rëndësishme të turizmit në Pogradec
16. Do të sigurohen botime artikujsh për promovimin e Turizmit në Pogradec, në revista prestigjioze kombëtare, si dhe në revista prestigjioze europiane (“Europe Tourism”, “Travel and Tour”, “Destinations Europe”, “Traveller” etj.)
17. Do të vendoset në sheshin qendror të qytetit të Pogradecit, e një mega-monitori për promocionin e turizmit, për reklamimin e biznesit që operon në sektorin e Turizmit, për njoftimin e aktiviteteve dhe eventeve që do të zhvillohen në Bashkinë Pogradec (në qytet dhe në fshatrat e tij). Mega-monitori do të jetë një ekran informues, reklamator, sugjerues, për vendasit dhe vizitorët, duke iu ofruar vizualisht asetet turistike që ofron Pogradeci
18. Do të kryhet organizimi i hapësirës Kamping, funksionale përgjatë gjithë vitit, ku do të mund të stacionojnë turistët/vizitorët
19. Do të ketë bashkëpunim me sportistë në Europë dhe jo vetëm, që ushtrojnë sporte ekstreme në ujë. Kjo do të jetë një formë shumë efikase promovimi, teksa Bashkia shtrihet në një prej liqeneve më të mëdhenj të Europës
20. Për periudhën Korrik - Shtator, do të funksionojë Kinemaja Verore pranë bregliqenit, për të gjithë kalimtarët dhe vizitorët, do të jetë një mundësi më shumë argëtimi dhe relaksi, por edhe një formë për të përçuar kulturën e flimit tek të gjitha moshat
21. "Do të kryhet hartimi dhe botimi: “Harta e Itinerarit Turistik në Bashkinë Pogradec”, në disa gjuhë
22. Do të kryhet mirëmbajtja dhe kthimi në të vizitueshme, i Bazilikës së Linit. Kjo vepër e trashëguar nga thellësitë e kohëve, duhet të jetë sot e vizitueshme prej gjithkujt që shkon në Lin, duke patur mundësinë që ta shohë
23. Do të kryhet pastrimi dhe menaxhimi i mbetjeve në Udënisht
24. Do të kryhet pastrimi dhe menaxhimi i mbetjeve në Boqezë
25. Do të kryhet pastrimi dhe grumbullimi i mbetjeve në Piskupat
26. Do të kryhet pastrimi dhe grumbullimi i mbetjeve në Lin
27. Do të kryhet pastrimi dhe grumbullimi i mbetjeve në Memlisht

28. Do të realizohet trajtimi i mbetjeve në Beragozhd
29. Do të kryhet pastrimi i fshatit nga mbetjet urbane dhe organike në Stropskë
30. Do të kryhet ndalimi i shpyllëzimit në Homezh
31. Do të kryhet pastrimi dhe grumbullimi i mbetjeve dhe largimi i tyre nga fshati, në Slabinjë

Fusha: BUJQËSI

Premtime:

1. Do të krijohen 4 ambiente për magazinim dhe frigoriferim të produkteve bujqësore me qëllim që fermerët të kenë mundësi për të rritur prodhimin dhe do të funksionojnë si tregje shitje për prodhimet
2. Do të ngrihet një strukturë brenda bashkisë e cila do të jetë e dedikuar për bujqësinë dhe blegtorinë
3. Dë të jepet ndihmë për vendosjen e çmimeve referente për produktet bujqësore dhe blegtorale dhe gjithashtu gjetjen e mundësive për afrimin e tregëtarëve për të blerë produktet në fshtrat e bashkisë
4. Do të hapen 3 baxho në vendet ku ka prodhime blegtorale
5. Bashkia Pogradec do të punojë intensivisht në mirëmbajtjen dhe hapjen e kanaleve për ujitjen, vaditjen dhe kullimin e tokave bujqësore të fermerëve të zonës
6. Do të hartohen studime për bio-energjinë
7. Do të hartohen politika çertifkimi, duke mbështetur fermerët në prodhim produktesh cilësore dhe konkurrenë në treg, me dy brande; “Mokra” & “Pogradec”. Kjo etiketë do të përfaqësojë produktet e zonës, për t’i bërë ato të dallueshme në tregun vendas dhe të huaj
8. "Bashkia do të orientojë fermerët drejt prodhimit të kulturave bujqësore që kërkon tregu vendas dhe i huaj, për t’i kthyer fermat e tyre në sipërmarrje efkase, fitimprurëse dhe efçiente
9. Bashkia do të bëjë analiza periodike të çmimeve dhe tregjeve, për t’i ardhur në ndihmë fermerit, duke e parë atë si prodhues dhe si tregtar
10. Do të realizohet krijimi i Rrjetit të Informacionit, logjistikës dhe statistikës për sektorin e Bujqësisë
11. Bashkia do të ndërmarrë brenda tre muajve të parë të punës së saj, iniciativën për krijimin e Rrjetit të Fermerëve të Pogradecit, regjistrimin vullnetar të të gjithëve në një bankë të dhënash, duke e parë këtë formë organizimi si më efikasen dhe më frytdhënësen, për të koordinuar aktivitetin prodhues dhe tregtar të fermerëve, si dhe për t’i dhënë mundësi produkteve, që të kenë brand-in e tyre “Mokra” & “Pogradec”, për të nxjerrë pas disa kohësh prodhime të çertifkuara në tregun vendas dhe të huaj
12. Do të hartohet projekti për hapjen e një Fabrike të Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore, për përpunimin dhe konservimin e fruta-perimeve
13. Bashkia do të mundësojë nëpërmjet Partneritetit Publik-Privat hapjen e dy kantineve për prodhimin e verës, duke i dhënë kështu një suport real zhvillimit të nënsektorit të vreshtarisë

14. Do të ndërtohet Tregu i Kafshëve, në pllajën kodrinore përballë fshatit Çërravë, do të bëhet rrethimi dhe parcelizimi i tij me gardhe druri, do të ndërtohen gjithashtu tualetat publike dhe rruga që të çon tek tregu
15. Do të hartohet Plani për krijimin e moleve të stacionimit të varkave të peshkatarëve, përgjatë gjithë vijës bregliqenore
16. Do të kryhet financimi i projekteve në fushën e kërkimit dhe përmirësimit të formave të menaxhimit të sektorit të peshkimit
17. Do të nxitet dhe mbështetet sektori privat ekzistues, që operon në përpunimin dhe konservimin e peshkut
18. Do të vendoset kjo motopompë, në Lin, për bujqësinë
19. Do të përmirësohet sistemi i vaditjes dhe infrastruktura në mënyrë që mokrarët të jenë sa më afër qytetit e të shesin produktet bujqësore
20. Do të kryhet sistemi i kanaleve ujitës dhe vaditës në Udënisht
21. Do të përmirësohet në Rodokali rruga e vaditjes
22. Do të kryhen investime infrastrukturore për vaditjen dhe ujitjen në Boqezë
23. Do të kryhet vendosja e pompave për vaditjen e tokave bujqësore në Piskupat
24. Do të kryhet vendosja e pompave për vaditjen e tokave bujqësore në fshatin Lin
25. Do të kryhet vendosja e pompave për vaditjen e tokave bujqësore në Lin
26. Do të kryhet krijimi i tregut për shitjen e produkteve bujqësore dhe pijes së verës në Lin
27. Do të investohet në vaditje dhe kullim në fshatrat Remenj dhe Zervask
28. Do të investohet në vaditje dhe kullim në fshatrat Zagorçan
29. Do të kryhet rehabilitimi i sistemit të kanaleve ujitëse dhe vaditëse, në Rëmenj
30. Do të përmirësohet sistemi i kullimit të tokave dhe do të ketë investime në kanalet kulluese në Zagorçan
31. Do hapen tregje që produktet e fshatrave Remenj dhe Zerask të shiten menjëherë në tregun e qytetit
32. Do u rikthehet përsëri banorëve pyjet e gështenjave, në Remenj dhe Zerask
33. Do të përmirësohen kanalet vaditëse, rrugë si dhe kushtet e tregut për të zhvilluar bujqësinë në Baçallëk
34. Do të përmirësohet sistemi i vaditjes dhe ujitjes në Zagorçan
35. Do të ndërtohet sistemi i kanaleve ujitëse dhe vaditëse, në Starovë
36. Do të vendoset hidrovori i kullimit në Starovë
37. Do të rikonstruktohet sistemi vaditës, në Leshnicë
38. Do të krijohet një treg që produktet në Nizhavec dhe Petrush të jenë lehtësisht të shitshme në qytet
39. Do të rikonstruktohet sistemimi i kanaleve kulluese në Nizhavec
40. Do të restaurohet sistemi i kanaleve vaditëse në Grabovicë
41. Do të kryhet sistemimi i kanaleve ujitëse dhe kulluese, në Petrushë
42. Do të kryhet sigurimi i ujit për vaditjen e tokave në Bletas
43. Do të rikonstruktohet kanali vaditës, në Plloç-Çërravë
44. Do të kryhet largimi / vendosja e stallave në periferi të fshatit Stropskë
45. Do të punohet në gjetjen e tregjeve për shitjen e produkteve në Stropskë
46. Do të kryhet sistemimi i kanaleve vaditëse në Pleshisht

47. Do të kryhet sistemimi i kanaleve vaditëse në Dunicë
48. Do të kryhet mbështetja e sektorit të blegtorisë në Malinë
49. Do të rikonstruktohet sistemi i kanalizimit, në Propisht
50. Do të kryhet sistemimi i kanaleve vaditëse dhe sigurimi i ujit për vaditje në Zall Torre
51. Do të kryhet sistemimi i rezervuarit dhe kanaleve ujitëse në Homezh
52. Do të kryhet sigurimi i ujit për vaditje në Slabinjë
53. Do të kryhet sistemi i vaditjes dhe ujitjes në Radokal poshtë dhe Radokal sipër
54. Do të kryhet mbështetja e bujqësisë dhe blegtorisë në Radokal poshtë dhe Radokal sipër
55. Do të kryhet sigurimi i ujit për vaditje në Golik
56. Do të mbështen fermerë në Bishnicë, Buzaishte dhe Laktesh, me ujitje dhe rrugë në mënyrë që të rritet punësimi në fshat e të rinjtë të mos emigrojnë
57. Do të kryhet menaxhimi i rezervuareve në Velçan
58. Do të kryhet sistemi i kanale vaditëse në Buzaishtë
59. Do të kryhet sistemi i ujitjes në Losnik
60. Do të kryhet sistemi i rrjetit të kanaleve vaditëse dhe ujitëse në Laktesh

Fusha: TRANSPARENCA

Premtime:

1. Do të bëhet transparente çdo vit mbledhja e taksave nga biznesi

Fusha: SHËRBIMET SOCIALE

Premtime:

1. Do të vendosen taksa të ulta për tregëtarët rom dhe egjiptian
2. Do të zhvillohen kurse profesionale falas për të rinj dhe të reja nga komuniteti rom dhe egjiptian
3. Do të shpërndahet ndihmë ekonomike për familjet në nevojë, nga komuniteti rom dhe egjiptian
4. Do të shpërndahen banesa sociale/banesa 'portative' për të pastrehët nga komuniteti rom dhe egjiptian
5. 30 fëmijë nga komuniteti rom dhe egjiptian do të marrin pjesë në një kamp veror
6. Lagjet romë do të jenë të pastra dhe pa mbetje urbane
7. Do të shpërndahen libra dhe materiale shkollore falas për fëmijët nga komuniteti rom dhe egjiptian
8. Do të zbatohen projekte në bashkëpunim me OJF për komunitetin rom
9. Do të mbështeten 3 aktivitete kulturore në vit nga komuniteti rom dhe egjiptian
10. Do të mbështeten artizanët e komunitetit rom dhe egjiptian me projekte dhe fonde
11. Do të kryhet dhënia e ndihmës ekonomike banorëve dhe familjeve me probleme të mëdha sociale dhe ekonomike në Memëlisht
12. Do të ndahet ndihma ekonomike për të gjitha familjet në nevojë, në Vërdovë
13. Do të ndahet ndihma ekonomike për të gjitha familjet në nevojë, në Zagorçan
14. Do të ndahet ndihma ekonomike për të gjitha familjet në nevojë, në Rëmenj
15. Do të ndahet ndihma ekonomike për të gjitha familjet në nevojë, në Starovë

16. Do të sigurohet asistencë për personat në nevojë, në Alarup
17. Do të shpërndahet ndihma ekonomike për këdo që e përfiton, në Leshnicë
18. Do të shpërndahet ndihma ekonomike dhe asistenca kujtdo familje që është në nevojë në Bratomirë
19. Do të shpërndahet ndihma ekonomike dhe asistenca kujtdo familje që është në nevojë në Qershizë
20. Do të shpërndahet ndihma ekonomike tek familjet në nevojë në Trebinjë

Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM

Premtime:

1. Do të realizohet ulja e taksave dhe tarifave në nivele minimale
2. Do të ndihmohen bizneset nëpërmjet kooperimit me donator dhe partner të huaj
3. Do të përmirësohet infrastruktura rrugore për bizneset
4. Do të ndihmohen bizneset nëpërmjet reklamimit dhe promovimit në rrjetin kombëtar të bizneseve
5. Do të kryhen trajnime të personelit të bizneseve private
6. Do të mbështeten bizneset për kredi në bankat e nivelit të dytë
7. Do të mbështeten bizneset në menaxhim e marketim
8. Do t'ju mundësohet plan biznesi për bizneset e reja
9. Do të investohet për pazarin dhe tregun e ushqimeve në tregun e Pogradecit
10. Do të ndihmohen sipërmarrjet e reja në konsolidimin e tyre nëpërmjet fondeve që do të mbledhë bashkia nga biznesi
11. Do të ndihmohen bizneset në gjetjen e burimeve financiare
12. Do të ulen taksat me 30 % për biznesin në mënyrë që të hapen sa më shumë vende pune
13. Nuk do të paguajë taksa për 1 vit çdo i ri pogradecar që kthehet në qytet dhe kërkon të hapë një biznes
14. Do hapet një zyrë me juristë në bashki që të ndihmojnë falas banorët për çdo problem që kanë me zyrat e shtetit si faturat e energjisë, pronat etj.
15. Bashkia Pogradec do të aplikojë dy sisteme Taksash dhe Tarifash Vendore për biznesin, me dy nivele të ndryshme mes Zonave Rurale dhe Zonave Urbane. Fermerët, Blegtorët, Peshkatarët dhe Sipërmarrësit në Zonat Rurale, do të kenë taksa më të ulta se Sipërmarrja në Zonën Urbane (në qytetin e Pogradecit)
16. Do të sigurohet punësim të një anëtari në familje, kur të gjithë anëtarët janë të papunë, në Lagjen 2, Pogradec
17. Do ketë prioritet hapja e vendeve të punës në fshatrat Remenj dhe Zervask
18. Do të merren masa për shmangien e minifaturimit të ujit të pijshëm në Rëmenj
19. Do të rishikohen tarifat e ujësjellësit në Zagorçan
20. Bashkia e re do ketë një zyrë me agronomë të zotë që do të punojnë me fermerët, në mbeshteje që të rrisim punësimin në fshat e te rinjtë të mos emigrojnë nga Bishnicë, Buzaishte dhe Laktesh